

*Mësuesve dhe shkollarëve filloristë,
dritëdhënës e dritëmarrës, si dje, si sot, si
mot e në pafundësi, që janë dhe mbesin
burim e ushqim i pashterrshëm i rrezeve të
jetës sonë intelektuale në vazhdimësi.*

Autori

Parathënie

Në këtë përmbledhje të tretë të "vjershave për fëmijë", pos krijimeve më të reja të mëvonshme, janë përfshirë edhe disa nga vjershat që u lanë me qëllim jashtë dy përmbledhjeve të para: Miklime (1967) dhe Rrezet e ylberta (1971).

Pothuajse të gjitha këto vjersha ndërkohë janë botuar në shtypin përkatës të ditës të ne, qoftë në revistën "Pionieri", qoftë në "Rilindjen për fëmijë".

Këtë rast e ndjej detyrim t'i them dy fjalë për dy rreshkje si borxh të cilat ma kanë gunduar zemrën, por edhe më kanë nxitur pastaj që t'i shfaq ndjenjat së paku me anë të vargëzimit:

E para lidhet me ndarjen nga "buzët në gaz" të mësuesit tım të parë Hilmi Duli (Rraxhimi) nga Shkodra, tek i cili pata rast ta gjejë po atë buzëqeshje vetëm pas dyzet vjetësh.

E dyta ka të bëjë po me këtë ndarje, po tash me këputjen e të drejtës që të ushtroj profesionin aq të dëshiruar të mësuesit. Mbase do t'u kujtohet ish-nxënësve të mi filloristë kur jam munduar t'i mbaj "buzët në gaz" edhe në ato raste kur më është hequr

5

ditari dhe në vend të tij më janë vënë, qoftë prangat në duar, qoftë në shpirt e në gojë (Mushëst 1952, Suharekë 1954, Grejçec 1957, Ferizaj 1962, Tankosiq 1963 etj.). Prandaj, kam të drejtë të meditoj, mbase jo aq talenti, po pikërisht rreshkja e madhe që të jem në kontakt me dëshirën ideal, ka bërë që unë herëpashere të përshëndes fëmijët së paku me anë të ndonjë vjershe.

Edhe pse jam vetëdijshëm se ish-nxënësit e mi që unë i kujtoj përherë shtalbakë, me ato fytyra aq të njoma, aq të mirë e të etshëm për dije, tashti nuk janë më filloristë dhe se vendin e tyre e kanë zënë fëmijët a nipërit e tyre, ata i përshëndes me përzemërsi të thellë se vërtetë janë ata që te unë kanë lënë mbresa të pashlyeshme. Ç'është e vërteta, që atje e ka zanafillën edhe ndonjë vjershë e suksesshme që është përfshirë në këtë përmbledhje.

Nëse do të arrij që te lexuesi i nderuar së paku me ndonjërin temë të trajtuar, qoftë zbatimëse, qoftë edukative a ndonjë tjetër, të zgjoj ndjenjën e disponimit dhe atij t'i vete "buza në gaz", do të ndjenim kënaqësi të veçantë dhe qëllimin tonë do ta konsideronim të arrirë.

Prishtinë, qershor 1997

Autori

6

ME BUZËT NË GAZ

Me buzët në gaz
rrezja
ndrin natyrën,
me buzët në gaz
vogëlushi
kryen detyrën;

plot gazmend
pranvera
syth-gongje zbukuron,
sa me gëzim
puhia
ballet i miklon.

Me buzët në gaz
te fëmija
plaku i ëndrrës vjen,
plot me afsh
dhe vargu
lexuesin e rrëmben!...

Vështirësitë
me brenga
që jeta i qet si vrer
me buzët në gaz
përpjiqu
t'i kalosh përherë;

7

Me buzët në gaz
dritëfati
të sfidon, të kapë,
ti me sytë
e mendjes
t'reja shtigje hap!



8

FALËNDERIMI

Mirëkuptoj prindët e mi
dhepse më rriten me halle shumë,
po m' stolisen me njerëzi
dhe më mbollën vullnet për punë.

Falënderoj dhe mësuesin tim
që m'dha mësim: forcë armë-jete
që çdo të mirë ta kem ushqim
dhe të mposhtë çdo të keqe...

Falënderoj trimat e parë
që u flijuan për ne -atdhe,
falënderoj punëtorët mbarë
që punojnë për jetë të re...

Përgëzoi lexuesin e ri
që nga bota e vet e thellë
të zbulojë t'madhen kënaqësi
që veç mësimi mund t'ia sjellë!

(R. për fëmijë, 9.III.71)

9

PRANVERA ME LULE

Pranvera, pranvera,
vrapo tash, o shok,
të dalim si ngahera
n'ograjë të lozim tok!

Lule t'bukura t'mbledhim,
vjollcës t'i këndojmë,
balonat t'i hedhim,
puhia t'na miklojë!

Shtrijma, shok-o dorën,
shtrijma gëzimplot
se pranvera borën
e përcoll pa lot!

Ashtu tonat brenga
kalofshin pa u ndjerë
ngrica, denga- shtrenga
mos paçim asnjëherë!

(Pionieri, 1970)

10

MIRËSEERDHËT DALLËNDYSHE

Mirëseerdhët dallëndyshe,
ne ju pritëm me dëshirë,
me stolirat e shkëlqyeshme
që i dhuron nëna natyrë.

Kahdo ngrohtë, me rreze dielli,
gjithkah jeta hov ka marrë
fusha veshë me lule prilli
u zbukuria bota mbarë;

N'për gemusha këndon bilbili
shkepen cimuret nëpër ajri,
kthjellët si loti rrjedh burimi
përshtëndet kështu miqt e rinj!

Shpi-bujtina për verim,
po ju pret te caku i vjetër,
zogjve tuaj jepnu këshillim:
Pastërtinë, kujdes më tepër!

(Pionieri, 1970)

11

DALLANDYSHES LOZONJARE

Tash që na u shkri bora
në vendim tim krejt,
fluturake mirëseerdhe
me ata krahët e lehtë!

Rrugës fluturimthi
dhe mbi tela ndenjor
përshtëndetna gëzueshëm,
mos na shiko vrenjtur...

Ne faj farë s' kemi
për çerdhet që s' janë mirë,
ngricat, dhëmbi i vitit
i gërryen pa mëshirë.

Për sivjet, të lutem,
lloçin kashë e baltë
sërish vër si duhet,
por jo tepër lart...


Sepse s' mund të të shohim
kah t'i ngrohësh vezet,
as qysh çelin voglat,
as si ju ndritin rrezet!

12

Ke besim të na lejosh
të luajmë me zogjt puplushë
se ne do t'i ruajmë
si shokët tanë vogëlushë.

Prandaj lozonjare
gjetiu mos ik fare
tek ne do të gjesh prore
ngrohësinë familjare!

(Pionieri, 4/79)



13

QERSHIA E VOGËLUSHES

Kur lulon qershia
që e kam në oborr
sa m' shtohet lakmia
që t'i prek me dorë...

Lulet i tret era,
gjethet rriten, rriten,
kokrra t'vogla, t'blera
duken, koloviten...

Diellin këndshëm ngroh,
hijeshon, qesh kurora,
koke verdhoshe shoh
që silëkuqen sahora!

Çdo m'ngjes hetoj
verdhime e kuqëlime,
tani zë të këndoj:
- U poq qershia ime!

-Eja moj vogëlushe,
buzëgaz më ftoi nëna,
merr në shportë ca të kuqe,
mbase, do t'i kënda!?

(R. për fëmijë, 26.V.61)

14

NGJARJA RRETH KOTECI

Vogëlush Leci
rreth koteci.

-Ki-ki-ri-ku-uuu?
-Për kaçiku uuu!

Kuqapeci
ik nga Leci.

-Kra-ka- kre-zë!
-Bëre vezë!

U krye puna
iku pula!

-Kllok-kllok-kllok!
- Ndalë, or bablok!

Tashti Leci
zbrapthi eci!?

-Ciu-ci-ci iii!
-Zogjt e rinj!

Iku Leci
larg koteci.

(1960)

15

KËSHILLË BUBURRECI

Jam i vogël, s'kam pashi,
por gjithkush më ka lakmi
se prej punës kurrë nuk ftohem,
shqim me punë prehem e ngrohem.

S'jam si fëmijë i pakujdes
qe shumë gjëra s'i merr vesh:
Sillet ftohshëm, pa gjall'ri,
pak punon për ardhmëri!

Shihna ne shembull n' detyrë,
të gjithë ngapak tubojmë yshyr
se ikën vera, dimri vjen
e lyp të sotmen, më s'e gjen!

Skamjes s'do t'i trembesh dot,
kur ta keshë hambarin plot...
Dëgjo buburrën, or voglush
Tash me mësimë kokën mbush,

T'sotmen për nesër mos e lë,
kujto të ardhmen me hare!
Kështu na mëson ne gjysh bub'rreci,
Bën si i miri, jo si i keqi!

(1960)

16

VJOLLCA VJOLLCËN ÇON NË SHKOLLË

-Vjollca, vjollca, lulëza ime,
- therret vogëlushja plot ngulshim -
vjollcë moj dashe, ja të pashë,
jam e lumtur që kësaj rashë,
ngreje kryet, lulëz e mirë,
të nduk me rrënjë po kam dëshirë
dhe në shkollë dua të dërgoj,
mësueses shoqeve t'u tregoj
se si je bukuria vetë
që pranvera të solli në jetë!
Të kam emnake, shpirt të kam,
jam e gëzuar, e lumtur jam!

-Ndal vogëlushe, sarrakuqe
-ndërhyn vjollca, rrënzë gemushe -
bleta e vyeshme para teje,
mirëmengjes na uroj neve,
për vizitë, këtu hala është,
mos ngatërrohi, merrnu vesh!

-Zë zëz, zë-zëz!..
Foli bleta me shqetësime,
ngjatjeta mikështa ime,
mos zgjat dorën, pak largoje,
se po më lëndove, mirë kujtoje,
e di ti: me më prekë s'duroj,
mund të vras veten, por të thumboj!

17

-Sa çudi si puna rrodhi,
mosmarrëveshje kot na ndodhi.
ti fletëlehtë s'hetit zukat
dhe si ngaherë gatitna mjalhtë,
sall këtë lule, ma fal, të lutem
për shkollë e kam, tani po ngutem,
ti gjej të tjera, shumë sa të duhen,
lulet ty fare s'të druhen.
Këtë po e marr me këtë dhe të zi,
që të jetojë një kohë në saks!...
Le ta shohin shoqe e shokë,
se si rritet vjollca në tokë!

Kështu vogëlushja mor pëlqimin
dhe me nxit vazhdoi rrugëtimin!

(1961)

18

HARABELI BUKËSHKAL

Beli, Beli - harabeli,
ç'bëri verës Bel-dembeli!
drihtë për vete nuk pat mbledhë,
dimrit barku i bënte dredhë!

N' këndin tim, sa për jetë,
hante dromca, i qitja vetë,
porse ku farë fluturaçi
asnjëherë nuk më kënaqi!

Hynte fsheht, dilte me turr,
shok më t' egër, s' pata kurr!
Kurrë s'kërkonte: leje, falje
as për hyrje as për dalje;

madje s' mësoi që *Beli* quhej,
unë mik beset ai më druhej;
fluturim ikte kah mali,
lamtumirë s' thoshte bukëshkali!

Tash sa ditë që rrezon djelli,
iku treti harabeli!...

(R. për fëmijë, 1974)

19

HARABELI DHE DJALI

-Harabel, or harabel
kah dritarja pse po më del?!
Pse, troket, me sqep *qok, qok (!)*
mos do t'më thuash gjë, si shok?!

-Po unë po dua të të them ty
kam filluar të ndjej uri,
vera e mirë shpejta kaloi
më trego dimrin si ta çoj?...

-Dimrit Baca, të hedh thërrime,
prandaj këndo, rro pa dertime.,
Besën fort në mua mbështete
Ruaju maces thonjperpjete!

(Pionieri, 2/76)

20

PËLLUMBI IM

O pëllumbim¹
qafëtulak,
gugubërës
e fluturak

sillu, sillu
përmbi ne,
endu endu
deri në re.

Fluturimth
or gugufu,
vështro lart
prap kthe këtu.

Sulu, sulu
me rembim
kthehu shpejt
në krahun tim,


1) pëllumbi im.

21

se armiku,
thonë, nuk fle,
gjatë lojëlmës
mund të të zë,

prandaj, gugu
pëllumb, pëllumb
më shpejt lojës
jepi fund!

(Pionieri, 5/79)



22

DEL LLASTIKU

U bubu,
qan cicamiu,
sot pa vëlla
mbeti fatziu!

Del rrugaçi
Del-llastiku
atij zemër-
shpirt i fiku!

Pse mor Del
ia ndale këngën,
pse mor Del
ia shtove gjëmën

pse s'e le
zogun n' qetësi
ta gëzojë verën
bashkë me ty?!...

Vallë, t' penguaka
pse qëron miza
pse banon
nëpër murriza?!

Tash cicërimën
këngë s'e ka,
por vajtëm
e gjëmë për vëlla.

(Pionieri, 4/71)

23

PËRQELLJA¹ E QYQES

Ku-ku, ku-ku, ku-ku!

Sot Xha-Moni shpalli lajm
sihariq, por si alarm:

Mu ke shpati në rreze,
te lisi në gemb të thatë,
qyqja zog-pranëvere:
qirret, qan, kukat!

-Kujdes fëmijë, ju lutem
si mikëpritës, dashamirë
zemërgrimën ta pranoni,
se erdhi mysafir!

Fëmijët pranojnë,
si s' pranojnë
mikeshë- shtrenjtën
duan ta nderojnë,

Uka premtoj krimba,
Cimi një gjysmë skrraje,
Buqja kokrra meli
për mikën shtegtare...

1) përqellje - përqeshje, tallje

24

Cufa gatit kafazin
shtruar me pupla t'buta
ku do të shlodhej mikja
e lodhur nga rruga.

Dhe Liria e vogël
që vaji e preku fort,
nxori faculetën
qyqes t'ia fshije lot!

Tash mbeti puna
qysh të merren vesh
qysh t'i thonë asaj
se e duan mikeshë?!

Por mikeshë e shtrenjtë
i pa me bisht syri,
iku shpejt nga erdhi,
aspak s'i përfilli!

Atëherë ai Xha-Moni
përzier me shpoti,
u tha: - Mos zhgënjehi,
o fëmijët e mi.

Qyqja s'ju don haje
as s'lejon të pjekur,
as s'do faculeta
as kafaz për të fjetur.

25

-Po pse bën kuku!
këndon a qan vallë?
-Do t'jua them të gjitha,
sikur thuhet në përrallë!

Por si duket fëmijë
qyqja qan pa lot
përqell ata lazdrana
që kukasin kot!?

(1969)

26

KALI I XHAXHIT

Xhaxhi im atje në fshat,
ka një kalë të mirë si at:
shalagjerë, jele-ballë balash
kokën lart e ngre dy pash!

Kushëriri im dhe unë
për të kujdesemi shumë:
e kashaisim, e lëmojmë,
e tagjisim... e shalojmë!

Më të lumturit ndjehemi n' botë
kur e shpiejmë në kullotë,
kur e ngasim trokth e vrap,
herë herë ankth e gaz na kap...

më duket se fluturoj mbi re,
e ndjej veten Skënderbe,
veç më mungon shpata e tij,
që t'huaj t'i japim lemeri!

Kali i Xhaxhit, balash-ati,
kur hingëllin më dridhet shtati,
por kur ai më shikon ëmbël
më bën të qeshem edhe ëndërr!

(Pionieri, 5/79)

27

**GJAHTARI
DHE KUKULLEPURUSHI**

Ukë micaku trevjeçar,
shpesh na bëhet dhe gjahtar!...

Kur merr pushkën me dy gryka,
i thotë lepurit: "Ik se të mbyta"!

E kur lepurit syrin s'lot,
atëherë idhshëm Uka i thotë:

More tucan, si t'ishe i gjallë,
s' do të më rrije, këtu për ballë,

por do të ikje fushës e malit
gjithë nga droja e Ukë-gjahtarit.

(Pionieri, 2/76)

28

PESHKËTARI KURESHTAR

Peshk, o peshk, dëgjomë,
ndal mos m'u largo,
a ke vëlla e motër
të drejtën ma trego,

Kur po të vjen gjumi,
kush ta shtron dyshekun
dhe kur të merr unë
kush ta gatit drekën?

Për lojë kur të teket
me kë do të biesh ndesh,
prindët a kujdesen
që brenga mos të keshë?

Është e vërtetë a jo
se ju çerdhe s'keni
se nuk keni shkolla
shfaqje fare s'keni?

S'di si e çoni jetën
sa ndodheni të mitur,
vallë, vërtet, ju ndjekin
peshqit më të rritur?

Ndal, mos ik prej meje,
desha pak të të lëmoj
besën po ta japi
në ujë sërish të lëshoj!

(Pionieri, 1970)

29

FAJI I IRIQIT

O iriq, o therrgjembaç
Për ty mall s' më merr gjithaq,
se e ke bërë të madh një faj,
më mirë dhelpra të të hajë!:

N' furrik pulës me të pa besë
ia ke ngrënë ca kokrra vezë.

Për këtë meriton dënim:
shkopinj shpinës dhe dëbim.

Kot po shtrësh, rri si top,
mund të të rrah me gurë, me shkop,
por do të jap mundësi lehtësimi
që të më zbutet pak zemrimi:

kur ta rrah tash këtë teneqe,
ti hidh vallen leqe-leqe ...
ne të qeshim, të argëtojmë
dhe kështu dëmin ta harrojmë...

Por kur të çoj atje në pyll,
bën si të duash, këndej mos u sill,
se vajhalli, nëse të zë
t'i nduk gjembat një nga një!

(Pionieri, 4/79)

30

MJEKU I SHPEZËVE

Blerim-vogli
rri, bën mend
si të bëhet
mjek për shpend...

t'ia shëroj
zërin bilbilët
që të dëgjohet
gjatë tërë dimrit;

t'i mësojë rosat
bas e alt
që të jetë kori
më brilant;

t'i bëjë bibat
dhe bibanët
t'flurojnë
si aeroplanët;

ky dhe gjelin
do ta mësojë
me sy hapur
të këndoje...

31

Ndërsa zogat
që frikohen
do t'i ftojë
të vizitohen

e nëse mjeku
konstaton
mund t'u japë
nga 'i injeksion!...

...Disiplina
gjë e qartë
duhet të jetë
në shkallë të lartë!

(R. për fëmijë, 29.XII.70)

32

LOPARI I FERMËS

Dikur ishte
lopar fshati
jetë të vështirë
kishte i ngrati,

por me at mund
e kujdes të mirë
bëri fermë
tash jeton mirë!

dhe lavdohet
për punë të vet
çka e arriti
me të vërtetë:

- Kam lopë race
dhe i dua
ato qesin qumësht
si krua

thashë si krua,
them si det,
e ushqej, t'fhuash,
një qytet...

33

Por do të kem
dhe më shumë gëzim
kur t'kryejë shkollën
biri im...

veteriner
të bëhet me namë
zot i fermave
për këto anë!

Pra sa ta kryejë
shkollën e lartë
pos mish - qumësht
do të kem dhe mjaltë!

jetë me mjaltë,
jetë me vlerë
që s'e kishim
asnjëherë!

(R. për fëmijë, 29.XII.70)

34

SULË SHPEZËTARI

Me të drejtë
lavdërohet Sula
se është bërë
ekspert për pula.

Ai me babin
për çdo ditë
shkon në fermë
dhe shpezët rrit.

Atje ai paska
zogj e zoga
shumë më shumë
se fëmijë ka shkolla!

Sa për vezë
mos të bëjmë fjalë.
thonë, veç tregu
u bëka ballë!...


Dhe çudi
në këtë mori
asnjë kllloçkë dot
s'sheh me sy!

35

Po si u çelkan
gjithkëta, kaq mirë!
tregon Sula
në mburrje shkrirë:

I ngroh kllloçkë-
inkubatori
i ushqen, ja,
Sulë punëtori!

(R. për fëmijë, 26.I.70)



36

SKITARI

U vesh mirë e mirë
skitë i vuri në krah
mu sikurse baba
kur niset për gjah.

Baba vrap pas gjahut
kah ta çojë gjurmimi
ky shkon lugjesh kodrash
lyp shtigje skijimi.

Baba ndoshta tanë ditën
e pret gjahun kot
dhe ky kodër m'kodër
e ndjen veten pilot,

mirëpo kur të takohen
pranë tryezës së bukës
të dy fort lavdohen
si pas suksesit të luftës!

por nën plaf t'lavdimit
s'di pse i fshehin punët
kur ky ngatërron shtigjet
dhe babës i humbin gjurmët

37

Mbase kur të kuptohet
bota do t'i bëjë përrallë
por një fat fort i mban
se kështu veprojnë rrallë!

Kur kthehet në shtëpi
skitë i heq nga krahu
mu sikur babë lavdaçi
kur kthehet prej gjahu.

(R. për fëmijë, 12.XII.60)

38

DITA E PARË E SHKOLLËS

Erdhi dita për gjithë ne
dita me shkëlqime plot
fëmijët të mbushur plot hare
për në shkollë u nisën sot

Ditë e bukur na gëzon zemrën
na përcjell, na përshëndet,
pasi bukur kaluam verën:
nëpër shpia, n'bjeshkë o det!

Tani shkolla na bashkon
na i mbush zemrat plot gazmend
Buçet kënga lart jehon:
Mirëseerdhët në tuajin vend!

Mësues dhe nxënës pa shënjë përtese
në punët tuaja dhe më të vështirat
ju dëshirojmë t'korni suksese,
ju shoqëroftshin gjithë të mirat!

(R. për fëmijë, 12.IX.61)

39

NËNË, SA SHUMË TË DUA!

Të dua, nënë,
sa s'e pandeh,
të dua shumë
sa s'mund ta shpreh!

Më shumë, më shumë
se që duhet jeta,
se zogu pyllin,
se lulen bleta,

se rrezet ngrohëse
e dritën natyra,
se shqipja malet,
gazin fytyra,

se i eturi
burimin e kthjellët...
më shumë të dua,
je më e shtrenjtë

dhe të zotohem
si fëmijë i vyeshëm
se do të përpiqem
të jem i shkëlqyeshëm.

(Pionieri, 4/79)

40

ZILJA E SHKOLLËS

Zilja, zilja
xingëluese
ja thotë këngës
pak shurdhuese

xingër - xingër
lajmëron
tash mësimi
po fillon.

xingër-xingër
për pushim
tregon zilja
s'bën harrim.

Zëri i ziles
gjith tregon
çdo vëgëlush
sot po punon


po punon
dhe ka orar
si më i miri
qytetar

41

orar pune
orar mësimi
orar dreke
dhe pushimi.

pas pushimit
tok të shlrë
vazhdojmë punën
dhe më mirë!

(Pionieri, 4/71)



42

NË NJË VATËR TË DITURISË

Në skaj fshati, afër kroit
po shkëlqen godina e re
hyjnë e dalin si bletë zgjoit
fëmijë për lojë e dije nxe'...

..Vërej një çun, aty kah dera,
shikon anash pak me drojë,
por zog-malin s'e tremb vera
shpejt me shokë do të hidhet në lojë;

pak më tej një gocë micore
ngrehacake, vetullat grep
shtrengon lapsin me fletore
si shqiponja prenë e vet!

gërshethedhur, ballëshkëlqime
si dallëndyshë na u tremb lehtë
dhe i shkuan fytyrës ca valë kuqëlime
kur na e tha emrin e vet!...

Të gjithë shkollarët shend e verë
vrasin mend për ardhmëri
se pa mësim s'ka jetë e nder
dhe pa punë s'ka lumturi!

(R. për fëmijë, 2.III.71)

43

NËNËS PËR DITËLINDJE

Çfarë të të fal nënë,
për këtë ditë,
ku të gjejë vallë,
një luledritë?!...

S'kam thesarë
çfarë ka bota,
s'mjafton zelli,
të mirat nota;

më thuaj, me se
të të përgëzoj,
s'mjafton vjersha
që ta kushtoj!?

pra, s'kam ç'të jap,
nuk kam pëshqeshe,
veç prano, nënë,
këtë **BUZËQESHJE**.

të cilën shqim
ta fal dhuratë:
Shëndet **NËNUSHE**
DHE JETË TË GJATË!

të fal **PËRQAFIMIN**
ja kështu të ngrohtë
të të bëjë më të lumtur,
të të bëjë më të fortë!

(R. për fëmijë, 6.III.79)

44

LULE ZEMRE PËRGËZIME

-me rastin e 8 Marsit -

-Mori Lule me një lule,
pse përpëlitesh në mendime,
pse ke rënë në kaq kujtime?

-Si të mos kem Gjysh, halle unë,
dhuratë kam një, dëshira shumë:
kë të gëzoj: gjyshen, nënën, tezen,
hallen, fqinjen, mësuesen, mjeken...
cilën motër, cilën shoqe ...
çfarë të bëj me një "lulkërroçe"?!

-Ja ta them Gjyshi, pa kurrnjë të keqe,
lulen ta ndalim, stoli për vete (!)
e për të dashurat mjafton xhania ime:
veç ca fjalë zemre:
GJITHË TË MIRAT, PËRGËZIME!

-Më thuaj ti Gjysh, o babagjysh,
pse pranvera vonohet kot,
pse s'vjen më herët me lule plot?!

(R. për fëmijë, 12.III.85)

1) *kërroçe* 0 shterpe, mushke

45

PLAKU I VITIT TË RI

Kur maj' mali zbardhon faqet
unë **PLAK VITI** dredh mustaqet,
lëmoj mjekërren, e rrudh pak ballin
se shumë të madh po e kam hallin:

të gjithë fëmijët si t'i gëzoj,
si të mbaj radhën, si të veproj?!...

...Në sytë e dritës, të fërfërimit,
në mbretërinë e endërrimit
dhe në botën përrallore
ku jetoj e mbetem prorre,
gjeta mbështetje, të madh thesar:
kalëshalëdrite, praruar në ar:
të vlerë, të padukshëm, fluturak
çil-mbyll syrin: botës qark!...

Dhe kështu shpejt zgjedh nga dëshirat
krejt dhuratat më të mirat:
foto, libra, lodërtira,
veshje-mbathje, ëmbëlsira!...


Tash plot gaz, pra kam fytyrën
se me nder mund t' kryejë detyrën:

46

dhuratat e vitit të ri
do t'i shkep me siguri
dhe vë vulë - gisht mbi çdo urim
që të shpërndahen më me gëzim...

Prandaj pritmë, or ti vogëlush,
toptan dëshirën ta përbush.
Prindin tënd përqafe shumë.
në gaz të tij ndodhem dhe unë!

(R. për fëmijë, 30.XII.75)



47

CIM-HOKATARI

A e njihni Cim-zgjtatinin
shakaxhiun, llafazanin
që qet fjalë shpesh pa peshojë
dhe kështu shokët i vë në lojë.

Njëherë mjaft shumë llototiti
dha e dha e gjithçka qiti,
për Yllukën që mëson shumë,
kinse bëka punë për lumë,
kinse u hyka punëve të vështira
tue lodhë syrin nëpër libra,
kurse ky na e paska gjetur,
se na u mësuaka pa mund: fjetur!

-As që lodhem, thotë, lavdaçi,
se mua më ndihmon zarçi:
Para se të bijë në gjumë
ia lëshoj librit një shikim,
t'më besoni, s' lexoj unë,
por i them ca fjalë n'yshtnim!...
...dhe kur zgjojhem, pa mundime
dija e librit në kokën time!

48

Kështu habitej dhe orëpasore,
mësimet sapak i la pas dore...
Dhe kur provimi i doli keq,
anash diku u nda si veç:
duart shtrëngonte, kokën kruante,
prej inatit dhëmbët i luante
dhe i tha vetes fort ngadalë:

-Eja në vete, more djalë,
lëri proçkat¹, mëso, të paça,
me shaka s'fitohet klasa!

(Pionieri, 6/79)

1) proçka - fjalë e papeshuar.

49

PENDIMI

Si biban na fryhej
vogëlushi Xali,
kur diçka i thuhej
për kokëfortësi;

dhëmbë e buzë shtrëngonte,
fjalët i zinte në grykë,
për gabime të veta
as që e qante kryet;

kur e derdhi ngjyrën
fajin s'e pranoi,
kur s' e kreu detyrën
veten e shfajsoi!

Dhe kur feu fjalë rëndi
as falje nuk kërkoi,
symësy për faj që bëri
mohoj, përgënjështroi!...

Kur shokët në një tubim
me fakte e bën "batare"
ku si spec i skuqur
rinte, s'fliste fare?

Ashtu përmes dridhjes
e djersësh kapluar,
thellë vendosi në vete
për t'u përmirësuar.

(Pionieri, 4/71)

50

TEKNIKU I RI

Unë jam teknik i ri
kibernet, jam montator,
punoj bashkë me shokët e mi
në kabinetin tonë shkollor...

Kur të bëhen inxhinier
kompjuter të ri do të shpik
që të ketë të madhe vlerë
si mjet shkencor elektronik!

Ai çdo fëmije t'i shërbejë:
qoftë për mësim, qoftë për lojë,
shpejt detyrat t'i zbërthejë,
prorë të ndihë dhe të dëgjojë...

(Pionieri, 1/71)

51

SPIKERJA MUZIKTARE

Zëmira Ylberë
që fort mirë lexon,
në radio si spikere¹
do t'japë emision;

me zë të ëmbël, të plotë
do të na njoftojë shqim,
për ngjarjet në botë
për mësim e argëtim...

Dhe me recitime
do të na befasojë
dhe këngë-kompozime
do të na këndojnë...

Për shoqet dëgjuese
dhe hallën Didare
s'do të jetë vetëm folëse,
por dhe këngëtare!

(Pionieri, 5/61)

1) spikere - folëse.

52

VOGËLUSHJA NË TELEVISION

Flora lozonjare
bukur, ec vallëzon,
prandaj ia ka ënda
të dalë në televizion

që ta bindë Babin
dhe vëllain, Avdinë
se di ta përhedhë shtatin
sikur balerinë:

me hape të lehta
me krenari në ballë
do t'i duket Gjyshes
si princesha në përrallë;

do që ta shohë Nëna
dhe shoqet kurreshtare,
kah i skuqen faqet,
po kjo s' trembet fare

dhe si valleheqëse
e ëmbël gojësheqere,
shpejt sillet përhidhet
posi zog pranvere!...

(R. për fëmijë, 18.III.69)

53

MANIKENJA

Është e vogël
pak çapkëne,
vishet mirë
si manikene

Flokët e pastra
i lidh kurorë
me kordelin
bardh si borë,

vesh fustanin
ngjyra-ngjyra
edhe ecën
në shumë mënyra

e vë trikon,
në njërën anë!
-bën, si s'bën, thotë,
si n'reklamë!

tufëbisht lepuri
vë në gjyksore,
për kureshtje
atraksione...

Vishet, ngjishet
sipas modës,
do të jetë shembull
për fëmijë të botës!

(Zëri për fëmijë, 21.III.69)

54

SHENJTARI

Sokol ma ka synë
drejton si me penj,
provon djali ynë
për të qitur në shenj.

Vazhdimisht ushtrohet
mu sikur ushtar,
se do të dallohet
si i mirë shenjtari.

Për pushkën mësoi
në paraushtarak
ta përdor, ta dojë,
mos të shtjerë pa shkak.

S'duhet luajtur tyta,
s'bën të dridhet dora,
n'se shenjon kojrija,
nëse gjuan sorra.

Ky si gjahtar trim
me çiften vrasore
do t'vrasë bisha pylli
dhe dhelprën dëmtore...

Mësoi të vrasë shenjën
dhe me revolver,
në ushtri ka mendjen
të bëhet oficer.

(Pionieri, 1/71)

55

ANGJELINA DHE MANDOLINA

Ximi-xim, ximi-xim!...
Vëllai i Angjelinës
i bien mandolinës.

Rri, vë vesh vogëlushja
n' prehër t' nënës struktur
do si vëllai Fatoni
t'i bjerë... dhe më bukur!

Por gishtat e njomë
të Linë -vogëlinës
vriten në telat
e hollë të mandolinës.

Ashtu me afsh plot
ish e... si n' përfitim...
vetë lehtë luante gishtat:
ximi-xim, ximi-xim!...

përcillte dhe këndonte,
Fatonin linte pas
gjithë duartrokitësit
mironin plot gaz!...

56

Por kjo nuk shkoi gjatë
iu ndërpre ngazëllimi,
me të hapur sytë
e preku pak dyshimi!

Mandolinën mori
që tash ish varë në mur
dhe filloi me i ra,
-por vallë... tjera duar!...

U skuq buzët dridhi
nga dëshpërimi vrarë,
-Nënë përvojshëm, thirri,
ç' kam, çfarë ka ngjarë?!

-Tash fli bija ime,
rritesh, mësohesh mirë,
mami, n' shkollë të muzikës
do të çoj me dëshirë...

(R. për fëmijë, 12.IV.66)

57

USHTARAKU I VOGËL

Ka fytyrë t' njomë prej kalamani,
por ka zemër partizani,
vigilent rri n' pozicion,
gjith' i gatshëm për aksion...

"infirmier" nuk quhet kot,
çanta e tij ilaçe plot,
qysh në kursin "Ndihma e parë",
mbante veten "shok ushtar".

Dhe tashitë në këtë manovër,
po tregon gatishmëri:
le ta dijë, thotë, bota e mbarë,
sa kreshnik është brezi i ri.

Në malet tona urti plot,
thonë për mikun bëju mik,
fushat tona, s' durojnë dot
t'i pllakosë ndonjë rrezik...

Bëjmë sytë katër ne ushtarët,
s'mund t' na gjejë kush në befasi,
amanet na e lanë të parët
pushkën n'dorë, barutin në gji!...

(R. për fëmijë, 22.XII.70)

58

RRËFIMI PËR KUKULLËN E DRITËN RROBAQEPËSE

Drita ka një kukull, të hijshme, shtathynshë
vetullzezë, sybukur që vetëm di të
buzëqeshë.
Drita shumë e do, shoqe e ka në lojë,
por edhe ajo vetëm di ta gëzojë.

Një ditë nëna Dritës i qepi fustan të ri:
me lule gjithfarëve, me pika mavi.

Fustanin sa e veshi, kukulla i buzëqeshi!

Dritës i shkoi në mendje: pa veshë shoqja e denj*,
s'vonoi gjeti basmën, mor gjilpërë e penj,
shpejt e shpejt ia nisi tërthuer e tegel
fort mirë ia ujdisi: atë fustan cubel!...

Kukullës kur ia veshi, ajo i buzëqeshi.

Drita, thuaj, çdo mbrëmje, fustanet shikonte,
kukullës shoqe gazin ia dëshironte.

...Rrezet e diellit binin gjithkund,
e ngrohnin barin dhe rërën në lumë;
lozin vogëlushet me gaz e hare,
kurse pluhurit të fushës pak i vini re...

Një mbrëmje Drita, vallë, kush mund ta di,
buzëqeshjes së kukullës, pse i bëri zili!?
(1965)

59

**RRËFIMI
PËR NALLONET PIKAKUQE**

(R. për fëmijë, 27.VI.67 në vazhdimë)

1

Merrmë, nënë, në treg,
me ty, po dua me dalë,
s'kërkoj gjë t'më blejsh
të jap besë e fjalë;

dua të të shoqëroj
shportën do ta baj,
s'jam tashmë e vogël
zotimin fort e mbaj;

kah t'ecim trotuarit
nuk të kap për kinda,
s'do t'i shikoj fare
lodrat në vitrina...

se shumë jam hidhëruar
në kukullën nazemadhe
që rri n'gaz kaçurrelja
dhe s'di të krihet fare!

60

2

Vogëlushja s'na i dashka
as kukullat me nazë,
as qoftët e ngrohta,
as simitet taze;
s'dashka trotinete,
as flutura -ere,
torte, as bonbone,
llokum, karamelë;

papuçet me tufa,
balonat pipili
diçka s'po dëshiruaka
as t'i shohë me sy;

sa për rrakataqe
e basmën pika-pika
me lule gjithfarëshe
as që i qaska çika!

Të gjitha t'i besoni,
mos t'u vijë çudi,
se vetë ia tha s'ëmës
sa ishin në shtëpi!

61

3

Flora tash me nënën,
përkrah e si për ane
në të dalë të rrugës
hetoi do nallone:

të vogla, sa për këmbë
të bukura rrypagjane,
që nallçet me qoshe
i kishin pikaloshe...

Dhe s' mundi të durohej,
i shikoi dhe -"Ah!",
pa pritë e pakujtuar
i doli një "ofshah"!

-Çke bijë që u skuqe,
ofshën, çka ta nxori?
-Nallonet pikakuqe,
nënë, kurrkush s'i mori!

Nënë, e dashura nënë,
kurrëgjë(!)...besë kam dhënë!

Nëna, vuri buzët në gaz
belbëzimin ia kuptoi;
s'bëri një as dy
dëshirën ia plotësoi.

62

4

Goca me nallone
dukej më e madhe,
ecte më me ëndje,
mbahej fort krenare...

ecte n'për oborr,
dilate me to në rrugë,
shpesh ngarendte thekshëm:
traka-truka-truk!

Nga gëzimi i tepërt
s'e zinte vendivend
shpesh habiste veten
sillej si pa mend:

Në pluhur të rrugës
luante bëhej tym,
kthehej me to mbathur
hipte mbi qilim!

-Ke mendjen moj bijë,
nëna e këshillonte,
por Flora pa të keq,
thuaj, s'e dëgjonte!

63

Çupa jonë vogëlushe
prindërve u shërben,
të mirat me të mirë
ajo ua shpërblen!

por... sot si papritur
nga një pakujdesi,
nënës i dha të drojtur,
vetes lot në sy!

Kur Babi kërkoj kafen,
çupa rend t'ia shpjerë,
por qe kah e then qafën
se këmba iu përdredh!

Vrau pak buzë e dhëmbë,
shkak nallonet në këmbë!

Por vogëlushja jonë
mori mësim me vend,
nënën ta dëgjojë
për të ecur me mend;

të zbathet, të mbathet
puna qysh ia thotë,
atëherë edhe prindja
do ta duan më fort.

LINDA VALLTARE

Linda, mori Linda,
di ti ç'është opinga?!
-E di, si s'e di,
aq të vockël
më pandehke ti?!

Së pari ato Babi,
i kam parë në muze
ku s' bashku me mamin
patëm shkuar atje.

Pastaj dhe në foshnjore
në një lojë - folklor,
më beso, të njëj shoqes sime,
në çast i pata në dorë!

Ua, sa ishin të lehta,
me xhufka në majë hedhur,
rreth e rreth me vjegëza,
me gjalmë, sixhima dredhur!...

Babi nëse më do
që në valle
të jem ndër të mira,
veshë kombëtare më blej
dhe një palë opinga!...

-Oh moj Linda e Babit,
o moj çupë valltare
po t'i shoh opingat
dhe veshën kombëtare.

(R. për fëmijë, 19.II.85)

KËSHILLA TË ARTA
TË GJYSHEXHANES

Ç'do mengjes, në nadjë, ashtu vrik e vrik,
rregullo vendfjetjen dhe bëj gjimnastikë!
Pastro duart, fytyrën, fytin ëmbëlsoje
dhe filloju punëve me vullnet, padroje!

Para dhe pas buke duart përherë t'i lajsh,
vegëlritë e rrobot në rregull, mirë t'i mbajsh!
Si në lojë dhe në punë, kërko gjej kënaqësi,
fjala e mirë dhe veshja të shtojnë në bukuri!

Para se të flesh, çdo mrëmje ta dish,
laj këmbët e dhëmbët dhe pizhamet vish!
Dhe diçka të keshë, posi vëth në vesh:
kahdo që të sillësh vetëm na buzëqesh!

-Për këto këshilla të arta, falemnderit
Gjyshe,
po pse disa të rritur po veprojnë më ndryshe,
vallë vetëm për t'vegjëlit vazhduakan këto të mira
e për të moshuarit ndryshuaka natyra?!

-Paj, në botë, mor bijë, ka edhe harresa,
për këtë gjë nuk duhet të lindin ngatërresa...
Disa shprehi të mbara që në vegjëli fitohen,
të mirat me të këqijat s' duhet të ngatërrohen.

(1985)

SIGJËGJËZA E GJYSHES

Pa më thuani, fëmijët e mi,
çfarë sjell gjithmonë lumturi?!

Si ta zgjidhni këtë gjëgjëzë
dhuratë keni nga një vezë!

Dhe përgjigjet rodhën shpejt,
pyetja dukej fort e lehtë:

-Lumturi sjellin dhuratat,
përkëdhelitet edhe lëvdatat;
-sjell bilbili kur këndon;
-sjell lul'njoma kur erëzon;
-sjell sofa me ëmbëlsira,
-sjell sukse si me nota të mira;
-sjell shëndeti, drita, rrezja,
-kur vjen halla, -kur vjen tezia;
-sjell mikëpritja përzmërore
dhe ai mik që të kupton prorre!...

Por gjegjja e Gjyshes si kapak
ish mbi të gjitha kishte hak:
-Ju dhuratën e fituat,
por plotësisht nuk ia qëlluat:

puna kur të bëhet shprehi
ajo përherë sjell lumturi,
Punën kuptonie një silojë, gëzim
jo si një dhunë, si një urdhërim,
prandaj luani, këndon, gëzoni,
po PUNËN kurr mos e harroni.

(Pionieri, 7/79)

GJYSHIT PËR 60-VJETOR

Një buzëqeshje Gjyshit
për lojën "*lepurishte*",
një buzëqeshje Gjyshit
për "*ishte se ç'na ishte!*"

Një mirëkuptim Gjyshit
për të bardhat flokë,
një falenderim Gjyshit
për dije shumë në kokë!

Një përqaftim të ngrohtë
me fjalë për përgëzime
Gjyshit, pra, ia falim:
gjithë t'mirat për ditëlindje!

Veç një vërejtje Gjyshit
ia bëjmë, pa shaka,
tortën s'e ka të madhe
për aq sa vjet i ka!?

(Pionieri, 1993)

68

BUZËQESHJA E PRARUAR

-vajzushes Jetë me
buzëqeshje të lehtë-

Jetë, mori Jetë,
moti të njoh ty,
kur buzëqeshes së pari
sa ishe kërthi!

Pastaj më kujtohet
së dyti për urim,
sa qite dy tre hape
me drojë e guxim!

Paksa kur u rrite
qeshe dhe në oborr,
kah të mbante Gjyshja
veç me njërën dorë!

t' dëgjoja zë bilbile
na u bërë "foleqesh",
buzëqeshjen e mbaje
porsi vëth në vesh!

kur lodrat zëvendësove
me shokeshoqe plot,
gazin si dhuratë
nuk e tretje dot...

69

Prej nesh kur u ndave,
lojrat n'fushë fajtoje,
qeshjen nur na ktheve
me lule rrethkurore.

Njëherë t' thashë m' shaka:
të zura bilbile ngusht:
buzëqeshjen e praruar,
për lirim ke kusht!

Mirë, më the, pajtohem,
vetëm t'shkoj, më liro,
se buzëqeshje të artë
mund të të fal kurdo!

Borxhin, të thash, pas vitesh,
tash, kur shkoje n' shkollë!,
-S'di Xhaxhi, ma ktheve
n' gaz, e skuqur mollë!

E tash që po madhohesh,
s'ke më kah të shkosh
buzëqeshjen e artë,
kur do të na dhurosh?

-Xhaxhi, s'di ç'të them,
mbase bëhet mirë,
s'ka buzëqeshje të artë
pa qenë njeriu i lirë!?

(Pionieri, 1993)

70

ZËNKA QAJ E QESH

Qëndresa, stërmbesa
tash po shkel tri vjet
buzëqesh e qaf ëmbël
dhe lezetshëm flet.

Një ditë kur diellohej
me shoqeshokë te pusi,
kur loznin e këndonin
si zogu si kënduesi,

dhe pasi bën simite:
me ujë, rërë e llaç
dhe i qiten t'i piqnin
pa qerep pa saç

papandehur bëri
aq të madhe shamatë,
sa mori ushëtën gryka
e lugu shpat më shpat!

- Pusho, i them, mos qaj,
moj gocë qaramane,
s'je kurrfarë "qëndrese"
s'ke zemër t'fortë, t'madhe!

Për ca pikla uji
s' gajasë njeriu kot,
që t'i hodhi Xhaxhi,
vallë s'të mbyti dot?!

71

-Jo, po...Babi, Mami,
nguci stërçxhaxhaja,
befas, uji i ftohtë,
pikla shumë, të mëdhaja!

-Ah, vërtet ky xhaxhi,
xhaxhushi ngucaç,
s' meriton më kafe,
mollë, qaj as kulaç,

Është e keqe bleta
kur pa hak sëmbon,
është e keqe sorra
pse zogjt i sulmon.

E keqe është shakaja
kush nguc njerëzit n' bef
është hata e madhe
me gërگا për qejf!?

Ç' thua ta dënojmë
Xhaxhin për gabim,
mos i fal buzëqeshje
as t'ngrohtin për qafim

Ta ndëshkojmë pa i folur
tri ditë e tri orë...
le ta mbledhë mendjen:
mos me prekë me dorë!

72

*
Po ...për çudi në çast
pa mllef, ujë e bishë,
Xhaxhi e stërmbesa
na u qafën sërish!

(Pionieri, 1993)



73

BEFASIMI I BABAXHAXHIT

(Kushtuar vogëlushit 3-vjeçar, pesmerç
homonim i babait dëshmor Mustafë
Veselaj)

Pse Tafush më lë krahhapët
dhe s'më qaf shpejt si përpara,
vallë, do të thuash, se tash u rrite,
dhe për Babaxhaxhin s'ta ndien palla?!...

Ti vërtet, je i mirë shumë,
për lakmi i ke do punë:
po e dallon të mirën e të keqen,
ndëron gjyshen, hallen tezen,
bacat, xhaxhot, dadat më së miri;
tërë shtëpia t' ka djalë dëshiri...

Përparimet që i bën në jetë,
po na gëzojnë shumë me të vërtetë:

S'po i kap më therat me gishta
dallon hithin nga barnishta,
nuk po nguc më zogjt e pulës,
nuk po i gjen "behane" bukës,
bishthin macës s' po ia kreh,
këlyshit ashtin s'po ia ngreh;
po e mban mend mësimin e Lokës
nuk po i grah pa thupër lopës...

74

Po e bën dhe një punë për së mbari,
kur çojmë lule te Lapidari,
dy gishtat po i ngre drejt, lart
shenj fitore dëshirë zjarrtë!...
dhe kur ligjërohet fjala "LAVDI"
ti buzëqesh dliër, mban krenari!...

Vërtet, po di "atë" "këtë",
por të mirë s'e ke çdo gjë:

Ke bërë faje me qëllim:
Ke derdh çajin mbi qilim,
nga tangari ke shkep hinin,
nga tepsia ke derdh miellin,
ke mbrec pak kabllin me rymë,
na e ke mbushur dhomën tym?

Një ditë befas ikur na ke
larg te lumi ke shkuar atje,
as kërkë me vete s' grishe,
sot me mua simitet prishe!...

Për këso gafesh skuqet veshi,
besa kërcet flakareshi...
keqalush, bubullush, halitan - mos u bën!

Ua, pse po i dridh buzët nën dhëmbë?!?!?

75

-?!?!

-Jo Tafush mos u përlosh,
BABAXHAXHI bën shaka,
shumë të dua, kurr s' të rrah
se të kam djalë, nip e vëlla!

Bazangaz, pra më përqafo,
Babaxhaxhi, ja, kështu të do!

(Reçan, maj 1992)

76

DJALI E TYMTARI FABRIKËS

Tymtari, lodër, shpon kupën qiellore
kopshin famëmadh të diellit rrezeditë,
me ëmbëlsi ngrohëse derdh shikimin prore
bashkë me reze jete që përtërin dhe rrit...

Dhe me hënë gaztoren, motrën e freskisë
që përkëdhël natën gjumëdhënësen qetësi,
shikon miqësisht damarët e ardhmërisë,
damarët e rinj, filizë njërezore plot gjallëri...

Dëshmojnë dhe pallatet, kuvli mrekulluese,
si hyje qyteti stolisin sa mot:
janë shlodhje vuajtjesh, mendjesh krijuese
shpërblyese e mundit, dritë për sot e mot...

Prandaj vogëlushi që e sheh jetën në
fabrikon në lojë të reja shumë të tillë tymtarë
që si djej do të ngrohin forcën në shoqëri
që të lulëzojë e nesërmja e popullit mbarë.

(1961)

77

RREZET E SHUMËNGJYRSHME

Rrezet e shumëngjyrshme
jeta na i dhuron
mu në mes t' errësirës
ndritin si neon.

Rrezet e shumëngjyrshme
nuk janë befasi
çdo punëtor i zellshëm
ato i mban në gjë.

Rrezet e shumëngjyrshme
krenari qyteti,
shkrepin të vocrraku,
shprehen te poeti.

Ato gjithnjë gufin
s'i ndan gardhi i zi,
rrezet e shumëngjyrshme
do të bëjnë mrekulli!

Kahdo që po shihet
ku njeriynë vu dorë
rrezet e shumëngjyrshme
thurin lavd-kurorë!

Zelli, mendja, forca
kur t' kenë një qëllim,
rrezet e shumëngjyrshme
veprën kanë: bashkim.

(R. për fëmijë, 16.II.71)

78

P Ë R M B A J T J A :

Parathënie,5

Me buzët në gaz,7
Falenderimi,9
Pranvera me lule,10
Mirëseerdhët dallëndyshe,11
Dallëndyshe lozonjare ,12
Qershia e vogluses,14
Ngjarja rreth koteci,15
Këshillë bubreçi ,16
Vjollca vjollcën çon në shkollë,17
Harabeli bukëshkal,19
Harabeli dhe djali,20
Pëllumbi im,21
Del llastiku,23
Përçellja e qyqes,24
Kali i xhaxhit,27
Gjahtari dhe kukulllepushi,28
Peshkëtari kurrështar,29
Faji i iriqit,30
Mjeku i shpezëve,31
Lopari i fermës,33
Sulë shpezëtari,35
Skitari,37
Dita e parë e shkollës,39
Nënë, sa shumë të dua!,40
Zilja e shkollës,41

79

Në një vatër të diturisë,43
Nënës për ditëlindje ,44
Lule zemre përgëzime!,45
Plaku i vitit të ri,46
Cim - hokitari,48
Pendimi,50
Tekniku i ri,51
Spikerja muziktare,52
Vogëlushja në televizion,53
Manikenja,54
Shenjtari,55
Angjrlina dhe mandolina,56
Usgtaraku i vogël ,58
Rrëfimi për kukullën e Dritën
rrobaqepëse,59
Rrëfimi për nallonet pikakuqe,60
Linda vallëtare ,65
Këshilla të arta ,66
Sigjëgjeza e gjyshes,67
Gjyshit për 60-vjetor ,68
Buzëqeshja e praruar,69
Zënka qaj e qesh,71
Befasimi i Babaxhaxhit,74
Djali e tymtari i fabrikës,77
Rrezet e shumëngjyrshme ,78
Përbajtja,79